



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha raportuese	Shtator, 2021
Emri dhe mbiemri i raportuesit	DKA

- ***Përmbledhje përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.***

Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit shtator të vitit 2021, ka arritur me sukses dhe rezultate të kënaqshme t'i realizojë të gjitha punët dhe detyrat të parapara me planin e veprimit me punë dhe detyra tjera.

- ***Aktivitetet e planifikuara - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj.***

- ***Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor.***

Mbështetja dhe mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar në komunën tonë, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik janë duke operuar në terren dhe duke i përcjellur nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale, në këtë kohë pandemie që po kalon vendi.

Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, drejtoresha e arsimit, znj. Shpresa Shala, së bashku me zyrtarët e DKA-së, ishin në vizita në SHFMU "Pavarësia", SHFMU "7 Marsi", SHML "Xhevdet Doda", si dhe në Institucionet Parashkollore, si IP "Buzëqeshja" dhe IP "Lulevera", për të parë nga afër respektimin e masave mbrojtëse dhe për të uruar fëmijët me rastin e fillimit të vitit të ri

shkollor. Ne do të monitorojmë në vazhdimësi procesin mësimor dhe respektimin e masave dhe bëjmë thirrje që ato të respektohen, në mënyrë që shkollat të mbesin të hapura për femijët tanë, Ju rikujtojmë se 90% e punonjësve të arsimit në Prishtinë tashmë janë vaksinuar.



- ***Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;***

-Sipas dinamikës së planifikuar, përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit gjatë muajit shtator, kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të Arsimit Parauniversitar.

-Në vazhden e mbështetjes për parandalimin e përhapjes së COVID -19, LDS Charity ka dhuruar 17,500 maska higjienike tri shtesore për mësuesit dhe stafin arsimor në shkollat e komunës së Prishtinës, si dhe për punonjësit social të Qendrave për Punë Sociale.

-Komuna e Prishtinës shpreh falënderimin dhe mirënjohjen për LDS Charity në ofrimin e donacioneve.

- ***Mbikëqyrja dhe mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);***

Në kuadër të mbikëqyrjes dhe mbështetjes profesionale, zyrtarët e DKA –së dimensionet që janë paraqitur nevojat.

Kështu që, sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë muajit shtator të vitit 2021, është realizuar plani i punës.

- ***Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësuesit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;***

Gjate muajit shtator janë informuar të gjitha Institucionet Parashkollore, se me fillimin e ri edukativ do të fillojmë me implementimin e profilizimit të edukatoreve.

- ***Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;***

Gjatë muajit shtator janë planifikuar dhe realizuar takimet bashkëpunuese të shkollave fillore të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta, lidhur me rishikimin e planifikimeve vjetore dhe detyrime të bashku me mësuesit.

- ***Hartohen politika dhe rregullore për zhvillimin profesional të mësuesve;***

Gjate muajit shtator për zhvillim profesional të mësuesve është bërë planifikimi dhe koordinimi me trajnerët e kurrikulës që të përgatitet trajnimi për drejtorë të shkollave dhe koordinatore të cilësisë "Vlerësimi për shkollë".

Trajnimi është realizuar në fund të muajit shtator dhe është planifikuar të marrin pjesë ose të trajnohen 25 edukatore për klasët parafillore të shkollave fillore është realizuar në tre module nga data 17 shtator 2021.

Trajnimi është realizuar nga Carritasi Zvicëran në bashkëpunim me DKA-në, ku qëllimi i projektit ka synim "Përgatitjen e Edukatoreve Parafillore për përkrahjen dhe zhvillimin e potencialit të fëmijëve përmes lojës dhe kreativitetit.

-Poashtu janë organizuar punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re.

- **Zbatimi i planit për tejkalimin e masave, sfidave, vështirësive dhe pengesave;**

Mbështetja dhe mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar në komunën tonë, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik janë duke operuar në terren dhe duke i përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale, në këtë kohë pandemie që po kalon vendi.



Kështu që, sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë muajit shtator të vitit 2021, është realizuar plani i punës.

Organizohen takime dhe punëtori për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;

-Më **14.05.2021**, është bërë kërkesë tek Institucioni i Avokatit të Popullit "Kërkesë për donacion të pasurive jofinanciare të cilat nuk i keni në shfrytëzim", e cila është aprovuar dhe gjatë muajit shtator 2021 është bërë pranim-dorëzimi i kësaj pasurie (laptop, shtëpiza, monitorë, UPS, printerë, radiatorë, skanerë:

-Pjesëmarrës në pranim-dorëzim të pajisjeve ishte drejtoresha e DKA-së, znj. Shpresa Shala, ministrja e Arsimit, znj. Arbërie Nagavci, përfaqësues të organizatave donatore, përfaqësues nga MASHT-i, zyrtarë të DKA-së, përfaqësues të shkollës dhe prindër;

-Pjesëmarrja në trajnimin për ekipin vlerësues, si dhe trajnimi për zhvillimin e data-bazës në nivel komunal për grupet e marxhinalizuara;

-Takimet të rregullta individuale me prindër;

-Takime për regjistrim në kopshte, shkolla fillore të mesme të ulëta dhe shkolla të mesme të larta;

-Takime të rregullta me komunitetin dhe organet e sigurisë;

-Takime me policinë në komunitet, me Stacionin Qendër dhe Jug, për të bërë planin për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022 dhe për të planifikuar aktivitete të përbashkëta për të siguruar siguri dhe vetëdijësim për nxënësit;

-Takimi i Kolegjiumit për Arsim (Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor).

Bazuar në veçantitë e sfidat që ka shkollimi para universitar në Komunën e Prishtinës dhe me përvojën e gjendjes së pandemisë prej fillimit por edhe dëshirën për tu angazhuar dhe kontribuar maksimalisht për të ndihmuar në lehtësimin e situatës shumë të rënduar nga pandemia(me pasoja afatgjatë në arsim) sot është mbajtur një takim me palë të interesit përkatësisht zyrtarë të Drejtorisë Komunale të Arsimit, këshilltarët për arsim të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, Kryesisë së Këshillit të Prindërve të Komunës, si dhe Asociacionit të Drejtorëve të Shkollave të Komunës së Prishtinës (me përfaqësues,drejtorë të shkollave) në

dakordim me kryetarin e Sindikatës së Arsimit të Komunës së Prishtinës. Pjesëmarrja ishte e plotë dhe diskutimi i sotëm ishte i pari i këtij lloji, por që do të pasohet nga takime të rregullta në vijim, me fokus të diskutimit e planit të kthimit të nxënësve në shkolla, më 13 shtator dhe vështirësitë e reziqet që na paraqiten për këtë. Më 08.09.2021, filloi trajnimi për implementimin e KKK për 306 mësuesin nga Komuna e Prishtinës për shtatë fusha kurrikulare.

Trajnimi u mbajt në SHFMU "Dardania".



Përfundimi i trajnimit sipas dinamikës së paraparë për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të mësimeve rreth implementimit dhe zbatimit në praktikë të KK-së, trajnim i cili lehtëson punën e mësimeve në procesin mësimor në mësime dhe mësimnxënie.

Zhvillimi i mendimit kritik tek nxënësit, nevojë dhe domosdoshmëri në bashkëpunim me ETEA.



- Takim me ADSHKP qëllimi i takimit ishte diskutimi lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor, si dhe analizimi i udhëzuesit nga MASHT-ja për skenarët e rikthimit.



- *Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;*
- Gjatë muajit shtator është planifikuar trajnimi, i cili do të realizohet nga CARRITAS-i zviceran në bashkëpunim me DKA-në, ku qëllimi i projektit ka synim "Përgatitjen e edukatoreve parafillore për përkrahjen dhe zhvillimin e potencialit të fëmijëve përmes lojës dhe kreativitetit;
- Janë organizuar punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Përgatitjet për fillimin e punëtorisë për planifikimin e vlerësimit në shkallë.



Në SHFMU “Andon Zako Çajupi” u bë pranim-dorëzimi i donacionit nga organizata “Konvoi der Hoffnung”, e përkrahur edhe nga organizatat EcoKosWomen, Rotary Gjilan dhe Rotary Club International Prishtinë, përfshinë: 8 ipad, 7 laptopë, 5 kompjuterë dhe një printer, pajisje këto të cilat i’u dhuruan nxënësve. Pjesëmarrës në pranim-dorëzimit të paisjeve ishte ministrja e Arsimit, përfaqësues të organizatave donatore, përfaqësues nga MASHTI dhe zyrtarë të DKA-së, përfaqësues të shkollës dhe prindër.





Rezultatet

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit u informuan me detyrat dhe përgjegjësitë e mësuesit mbështetës, funksioni dhe puna e Ekipt vlerësues komunal, rëndësia dhe përpilimi i Planit individual arsimor.

Materiali i ofruar nga trajneret si dhe shkëmbimi i përvojave gjatë trajnimit, do të kontribuojë në zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve nga stafi profesional për fëmijët me nevoja të veçanta.

Me këtë trajnim u mundësua edhe krijimi i grupit të mësuesve mbështetës të cilët do të zgjedhin edhe tre përfaqësues të tyre, për të përfaqësuar intereset e mësuesve mbështetës. Gjithashtu do të angazhohen në bashkëpunim me DKA-në të mbajnë takime dymujore, të cilat do të ndihmojnë shumë në përmirësimin e shërbimeve, duke shkëmbyer përvojat e tyre dhe duke ofruar ndihmë njëri-tjetrit, qoftë me këshilla apo me materiale shkollore për fëmijë me nevoja të veçanta.

Sfidat

Gjatë diskutimeve u veçuan disa sfida, të cilat e përcjellin punën e mësuesve mbështetës në shkolla.

Sfidë është numri i madh i fëmijëve me nevoja të veçanta në disa shkolla, si dhe mungesa e asistentëve personalë e rëndon shumë punën e mësuesve, si dhe mësueseve mbështetëse, mosbashkëpunimi i prindërve me mekanizmat mbështetës të shkollës për fëmijët me nevoja të veçanta, mungesa e zyrave (mësueset të cilat janë punësuar rishtas), angazhimi i tyre në rolin e



asistentës personale, me kërkesë të udhëheqësisë së shkollës, si pasojë e mungesës së informatave për rolin dhe detyrat e mësuesit mbështetës në shkollë etj.

Rekomandim

Me identifikimin e sfidave të punës së mësuesit mbështetës nga ky trajnim, rekomandojmë që është i nevojshën organizimi i një trajnimi (apo takimi) të tillë edhe me drejtorët e shkollave, në mënyrë që të informohen më mirë rreth detyrave dhe të drejtave të mësuesve mbështetës në shkolla.

Të organizohen fushata vetëdijësuese për prindërit për rolin e ekipit të vlerësimit, rendësinë e bashkëpunimit me mekanizmat mbështetës në shkollë për fëmijët me nevoja të veçanta.

Të forcohet bashkëpunimi në mes të mësuesve mbështetës, gjithashtu bashkëpunimi i tyre me mësueset udhëtuese nga qendrat burimore.

- *Shpenzimet komunale për institucionet shkollore*

Buxheti i shpenzuar dhe Alokuar SHTATOR-2021				
Kategoria Eko.	Alokim	Shpenzim	Zotim - Obligim	Mbetje -S=
Paga	1,493,402.99	1,493,402.99		-
Komunali	140,829.08	23,543.91	29,042.69	88,242.48
10-M.SH	1,216,348.30	113,072.54	123,954.62	979,321.14
21-M.SH	172,644.12	87,426.47	57,519.15	27,698.50
Subvencione	82,670.00	30,710.00	-	51,960.00
Donacione	76,256.62	75,756.62	-	500.00
FB-21-Kapitale	2,217,756.26	87,777.00		2,129,979.26
FB-22-Kapitale	2,650,279.37	64,234.61	39,488.58	2,546,556.18
FB - 04 M.SH	30,379.00	29,111.73	-	1,267.27
FB - 04 KAPITALE	28,146.00	16,775.50	-	11,370.50
Totali:	8,108,711.74	2,021,811.37	250,005.04	5,825,524.83

Prishtinë, 07.10.2021 ZLF Isa Avdiu

- **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.**

- **Shpërndarja e librave në institucionet arsimore**

MASHT në bashkëpunim me DKA-në, në Komunën e Prishtinës kanë bërë furnizimin me libra për vitin shkollor 2021-2022. Janë shpërndarë tekstet shkollore në tërësi për nxënësit e nivelit të arsimit fillor (I-V) dhe për nxënësit e klasës së tetë (VIII), si dhe tekstet alternative për nxënësit e klasës VI dhe VII dhe tekstet shkollore për lëndën gjuhës gjermane e frënge. Ndërsa, tekste tjera të klasës së VI, VII dhe të IX, duhet të përdoren të vitit paraprak.

- **Procesimi i pagesave për monitorues dhe administrues të Maturës shtetërore 2021**

- Në Komunën e Prishtinës për organizimin e Maturës shtetërore, pjesëmarrës për mbarëvajtjen e testit kanë qenë të angazhuar 414 administrues/monitorues, ku dhe për këtë edhe janë procesuar për kompensim monetar në MASHT.

Procesimi i të dhënave në sistemin SMIA

- Si çdo fillim vit, edhe në vitin shkollor 2021-2022 nga institucionet edukativo arsimore janë procesuar të dhënat në sistemin SMIA. Shënimet do të jenë bazë për planifikimin e buxhetit për shkollat.
- *Dinamika e punëve të realizuara gjatë muajit shtator*

Shpallja e rezultateve të Maturës shtetërore, afati i dytë.

Provimi i Maturës shtetërore, është vlerësim i njohurive, shkathtësive dhe aftësive të nxënësve, të cilat i kanë arritur gjatë shkollimit në nivelin e arsimit para-universitar në përputhje me Kornizën Kurrikulare të Republikës së Kosovës.



Marrja e masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 me rastin e fillimit të vitit të shkollor në objektet e IEAA.

Në Komunën e Prishtinës që nga fillimi i pandemisë jemi përkujdesur maksimalisht që të garantojmë respektimin e masave, rrjedhimisht mbrojtjen e jetës së qytetarëve. Sipas të dhënave që kemi kalkuluar gjatë kësaj jave, rezulton se 90,81% e punonjësve në fushën e arsimit në komunën tonë tashmë janë të vaksinuar. DKA poashtu ka pajisur të gjitha shkollat me mjetet e nevojshme dhe infrastrukturë për mbrojtjen e nxënësve dhe

punonjësve të arsimit nga rreziku i infektimit. Ne bëjmë thirrje për vaksinim tutje, rrjedhimisht mbrojtje më të madhe nga sëmundja COVID-19.

- ***AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:***

- Kontraktimi i një kompanie nga Komuna për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-së në shkolla;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Kontraktimi i operatorit për ekonomik për organizimin e transportit të nxënësve.

- ***Takimet me palë***

Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit shtator të vitit **2021**, ka realizuar mbi **82** takime me palë. Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara në katër ditë të javës.

- ***Takimet me institucione të tjera***

- Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me OJQ “Etea” për fillimin e zbatimit të projektit të fituar për SHFMU "Emin Duraku";
- Progresi i realizimit të planit të prokurimit;
- Takim me anëtarët e KEPTSH;
- Takimi i KSHLM-së;
- Takim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore, me rastin e fillimit e vitit të ri shkollor 2021-2022;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës – MASHT;
- Mbledhja e shtatë të KPF-së.

- ***Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare***

Gjatë muajit shtator të vitit 2021, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

- ***Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër***

Gjatë muajit shtator të vitit **2021**, janë pranuar gjithsej **64** lëndë, prej tyre të miratuara janë **4**, të refuzuara **3** lëndë, të pezulluara 27, të anuluar **0** dhe në proces janë edhe **30** lëndë.

- ***Takime të tjera:***

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takim me drejtueset e IP;
- Takim me përfaqësueset e edukatoreve në institucionet parashkollore;
- Takime me mësimdhënës.

- ***SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.***

- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional e mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Mungesa e zyrtarëve ligjorë në Drejtorinë e Arsimit;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Implementimi i Kurrikulës së re;
- Infektimi i mësimdhënësve me virusin COVID-19 dhe zëvendësimi i tyre;

- ***REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shitesë, etj.***

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësive, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;

• ***AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES -Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues***

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA-së;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Mbikëqyrja, mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit të (DKA-së shkollë), dhe mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;
- Hartimi i politikave dhe rregulloreve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
- Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për ZHPM;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave, sfidave, vështirësive, pengesave;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takime dhe punëtorive për ndarje të përvojave dhe praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re.
- Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikimi i nevojave të shkollës për mjete të TIK-ut;
- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- Identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë, kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Hartimi i listave për nevojat e secilës shkollë për punëtori, kabinete, laboratorë dhe material shpenzues;

- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave monitorues për përdorimin e kabineteve;
- Hartimi i rregullores që organizon (mbledhjen) ngritjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti, e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtarë të arsimit, zyrtarë të inspeksionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës, etj.) për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim, por edhe si këshillues e përkrahës – në të përfshihen edhe profesionistë – ekspertë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH-së;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativoarsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT-in dhe Qendren Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Organizimi i diskutimeve publike rreth regjistrimit në vitin shkollor 2020/2021, dhe konsultime me MASHT-in;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin, me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtë kurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA-ja përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit komunal për vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektive;
- Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonim;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA-ja harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektive;
- Organizohen ngjarje për vetëdijësimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimi nëpër shkolla;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;

- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

- ***TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.***